

“INFORMACION MBI KUSHTET DHE LISTA E CMIMEVE PER PRODUKTET E KREDISE KONSUMATORE, NE FUQI PREJ DATES 29.04.2024”

Qellimi I dokumentit	Ky dokument perben nje prezantim te kushteve dhe cmimeve te kredise konsumatore ne luteCredit.
Kontakte:	luteCredit Albania sha Rruga: Andon Zako Cajupi, Ndertesa Nr. 3, Hyrja 2, Tirane +355 44505060 info@iute.al www.iute.al
Qellimi I Kredise:	Kredite konsumatore ne vlera te vogla synojne te permbushin nevojat personale te individeve per blerje produktesh, apo nevojte te tjera te tyre.
Normat e Interesit	Norma e Interesit - llogaritet si nje perqindje vjetore mbi principalin e papaguar te huase per cdo periudhe dhe te shprehur si norma vjetore e 360 diteve te vitit dhe 30 diteve te muajit. Kredia Cash Shuma: 5,000 – 600,000 Lek Norma e interesit: 0%- 20% Afati: 2-48 muaj Kredia Dealer – Kredi per blerje produktesh ne pika te autorizuar Shuma: 5,000 – 600,000 Lek Norma e interesit: 0%-15% Afati deri: 48 muaj
Norma Efektive e interesit (NEI)	Norma efektive e interesit NEI eshte totali i kosos se kredise per klientin e shprehur si perqindje vjetore e vleres se kredise se dhene. Kostoja totale e kredise per klientin eshte totali i te gjitha shpenzimeve ku perfshihen interesat, komisionet dhe cdo lloj tjetere shpenzimi qe klienti paguan per kredine sipas kushteve te marreveshjes se kredise (shpenzimet per sherbimet ndihmese per marreveshjen e kredise, ne vecanti primet e sigurimit, perfshihen nese sherbimi eshte i detyrueshem per te perfitur kredine ose normen e interesit te aplikuar).
Komisioni i Procesimit	Komisioni i Procesimit llogaritet mbi shumën e kredisë dhe duhet të paguhet në ditën e nënshkrimit të Kontratës së Kredisë Specifike, megjithatë, palët bien dakord që Komisioni i Procesimit të paguhet së bashku me detyrimet mujore të kredisë, i ndarë në pjesë të barabarta sipas Grafikut të Pagesës, shtojcë e Kontratës së Kredisë

	<p>Specifike. Për të shmangur dyshimet, tarifa e komisionit të procesimit paguhet plotësisht edhe në rast të një shlyerjeje të parakohshme të kredisë ose përfundimit të parakohshëm të Kontratës për çfarëdo arsye.</p> <p>Kredia Cash Komisioni total: 0%-35%</p> <p>Kredia Dealer – Kredi për blerje produktesh në pika të autorizuar Komisioni total: 0% -52%</p>
<p>Komisioni i Administrimit</p>	<p>Komisioni i Administrimit llogaritet si përqindje mbi shumën e disbursuar. Ky komision shpërndahet në të gjithë kështet mujore të kredisë dhe falet në rastin e shlyerjes së hershme të kredisë.</p> <p>Për produkte dhe partnere të ndryshëm ofrohen komisionet e mëposhtme të administrimit:</p> <p>Kredia Dealer – Kredi për blerje produktesh në pika të autorizuar Komisioni i administrimit: 0 -4% në muaj mbi shumën totale të disbursuar</p> <p>Kredia Cash Komisioni mujor: 0%-1.9%</p>
<p>Komisioni i Shtyrjes së datës së pageses</p>	<p>Komisioni i Shtyrjes së datës së pageses është komisioni që paguhet nga huamarrësi në rast pezullimi të detyrimeve të Huamarrësit me kërkesë të këtij të fundit për disa ditë pa ndryshuar datën e pageses në grafikun e pagesave.</p> <p>Komisioni është 1,500 Lek për çdo shtyrje. Për çdo ditë shtyrje nuk aplikohet penaliteti ditë për ditë vonësore por në rast se klienti nuk paguan brenda afatit të shtyrjes atëherë në përfundim të këtij afati i aplikohet penaliteti ditë për ditë vonësore për të gjitha ditët e shtyrjes.</p>
<p>Levrimi i Kredisë</p>	<p>Levrimi i kredisë së klientit do të kryerhet në monedhën LEK në pikat e autorizuar partnere të IuteCredit. Këta partnerë janë: POSTA SHQIPTARE, Agjensite UNION NET WESTERN UNION, EASYPAY, RAEAFS, ATM ose në llogarinë bankare të deklaruara nga Klienti.</p>
<p>Shlyerja e Kredisë</p>	<p>Shlyerja e kredisë nga Klienti do të kryhet në përputhje me planin e pageses që klienti do të dakortesoje në momentin e nënshkrimit të kontratës së Kredisë.</p>
<p>Tabela e llogaritjes së NEI</p>	<p>Në rast se shuma e kredisë është 100,000 Lek dhe afati i saj është 24 muaj atëherë kështu mujor është 7,714.08 Lek (i rumbullakosur me përjashtim të kështit të fundit). Shuma totale që klienti paguan në fund është 185,137.92 Lek bashkë me interesat të cilat janë 22,149.92 Lek, bashkë me komisionin e procesimit i cili është 62,988</p>

	<p>Lek.</p> <p>Ekuacioni shnderrohet si ne vijim: $100,000 = 185,137.92 / (1+i)^{(6/12)} = 185,137.92 / (1+i)^{0.5};$ $(1+i)^{0.5} = 185,137.92 / 100,000$ <u>NEI = 93.67%</u></p> <p>i (NEI) – është norma efektive e interesit, e cila mund të llogaritet (nga algjebra ose nga një program kompjuteri) si me poshte:</p> $\sum_{k=1}^m K_k (1+i)^{-tk} = \sum_{l=1}^{m'} R_l (1+i)^{-li}$ <p>m - është numri total i kësteve të lëvrimit të kredisë, nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste (drawdowns), të paguar nga kredidhënësi. k - është kësti i k-të i kredisë i lëvruar nga kredidhënësi (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste), kështu që $1 \leq k \leq m$. K_k - është vlera e këstit të kredisë (drawdown) të vënë në dispozicion të klientit (të lëvruar) në periudhën k. tk - është intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së lëvrimit të këstit të parë të kredisë (first drawdown) të vënë në dispozicion të klientit (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste) dhe datës së çdo kësti pasues të kredisë të vënë në dispozicion të klientit, domethënë $t_1 = 0$. m' - është numri total i kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë dhe/ose pagesave të shpenzimeve. l - është pagesa e l-të e kryer nga klienti për shlyerjen e kredisë ose pagesën e shpenzimeve. R_l - është vlera e këstit të shlyerjes ose pagesës së shpenzimeve nga klienti në periudhën l</p>
Komisioni i njoftimit te Voneses	Komision i Njoftimit te Voneses ne kete kontrate dhe kontratat specifike qe do te lidhen ne kuader te saj ka kete kuptim: eshte kuote qe paguhet nga Kredimarresi per te mbuluar shpenzimet administrative qe ben Kredidhenesi per te njoftuar kredimarresin per pagesen e tij ne vonese me ane te mjeteve te qendrueshme te komunikimit te tilla si Leter njoftuese (shpenzime administrative per pergatitjen dhe dergimin e letres si dhe njoftimet e tjera me ane te telefonatave) dhe sms (shpenzime administrative per pergatitjen dhe dergimin e sms). Ky komision parashikohet ne cdo kontrate specifike.
Kamat vonesa ditore dhe	Huamarrësi është i detyruar t'i paguajë Huadhënësit Kamatëvonesën në rastin e pagesave te kesteve qe kryhen pasi ju ka kaluar afati (pagesa ne vonese) në

Penaliteti ne daten e mbylljes se kontrates	<p>shlyerjen e detyrimeve. Kamatëvonesa do të jetë 3 % (tre për qind) në ditë e llogaritur mbi shumën e principalit plus interesin e cdo kesti në vonese duke nisur nga e nesermja e dates kur detyrimi është bërë i kërkueshëm. Kamatëvonesat e parashikuara të cilat paguhen nga kredimarrësi, nuk tejkalojnë në asnjë rast më shumë se 30% të shumës së detyrimit kontraktor (kestit/kestëve të papaguar të kredise). Zbatimi i Kamatëvonesës nuk cenon të drejtën e Huadhënësit për të nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm apo për të zgjidhur Kontratën në përputhje me parashikimet e saj.</p> <p>Penaliteti ne daten e mbylljes se kontrates është 30% të Principalit e të gjitha kesteve të ardhshme duke nisur nga data e mbylljes se kontrates.</p>
E drejta e terheqjes nga kredia konsumatore	<p>Klienti ka të drejtë të terhiqet nga kontrata e kredise për një periudhë 14 ditore nga data e nënshkrimit të kontrates. Në rast se Klienti ushtron të drejtën e tij për t'u tërhequr nga Kontrata e Kredisë Specifike, ai do t'i kthejë Kredihënësit shumën e kredisë dhe do të paguajë interesin e përlllogaritur për periudhën nga data e nënshkrimit të Kontratës së Kredisë Specifike deri në datën e shlyerjes së shumës së kredisë dhe interesit të përlllogaritur, pa vonesa të panevojshme dhe jo më vonë se brenda periudhës 14-ditore të tërheqjes. Interesi llogaritet në bazë të normës së interesit në ditë siç është rënë dakord në Kontratën e Kredisë Specifike.</p>
Shlyerje perpara perfundimit te afatit te kredise	<p>Nese klienti e mbyll kredine perpara kohe, falet 100 % i interesit dhe komisionit të administrimit të mbetur për muajt pasardhës ndërkohe që komisioni i procesimit do të shlyhet sipas kushteve të rena dakort.</p> <p>Në rast të shlyerjes përpara perfundimit të afatit të kredise komisioni i shlyerjes përpara kohe është 0 Lek.</p>
Komisione per leshim vertetimesh / dokumentacioni	<p>Vërtetim mbyllje kredie 2,000 Lek; Vërtetim balance kredie 2,500 Lek; Kopje e Kontratës së Kredise 2,000 Lek; Vërtetim për mbyllje kredie brenda 14 ditëve – 5,000 Lek; Kopje e planit të pagesave (<i>installment table</i>) –1,000 Lek; Ndryshim i kolateralit për Kreditë e Makinave – 2,000 Lek; Bllokim i kolateralit (mjet motorrik) në RBS – 1,600 Lek; Zhblllokim i kolateralit në RBS – 2,000 Lek.</p>